



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-KUVENDI I KOMUNËS-
01Nr. 16-12287/2013
Kaçanik, 29.04.2013

Në bazë të nenit 13.1 të Ligjit 2003/14 për Planifikim Hapësinor të Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 2003/14, të nenit 17 dhe 40.2 (l) të Ligjit 03/L-040-Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenin 6.2 (b) lidhur me nenin 34.5 e Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të kryetarit të komunës 01Nr. 16-12287 prej datës: 19.04.2013, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 29.04.2013, mori këtë,

V E N D I M
PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES
URBAN TË ZONËS SË II-të dhe ZONËS SË III-të URBANISTIKE TË QYTETIT TË
KAÇANIKUT

I.

Me këtë Vendim, vendoset të fillohet me Hartimin e Planit Rregullues Urban të zonës së II-të dhe zonës së III-të Urbanistike të qytetit të Kaçanikut.

II.

Ky Vendim do të përmban kufijtë kadastral të zonës së II-të urbanistike janë në sipërfaqe (143.50 ha, nga e cila sipërfaqe hiqen, 22.89 ha, që janë trajtuar me Planin Rregullues Urban (PRRU) të zonës së I-r Urbanistike të qytetit të Kaçanikut dhe mbesin **120.61 ha** sipërfaqe të zonës së II-të urbanistike, dhe sipërfaqja **143.40 ha**, e zonës së III-të Urbanistike, të caktuara sipas Planit Zhvillimor Urban, për qytetin e Kaçanikut, të cilat zona kanë sipërfaqe të përgjithshme prej, **264.01 ha**.

III.

Për udhëheqjen e procedurave për hartimin e Planit Rregullues Urban të zonave të përcaktuara si në pikën I dhe II të këtij Vendimi dhe procedurave të tjera që lidhen me këtë çështje, do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, ndërsa Drejtoritë tjera komunale janë të obliguara që të sigurojnë shënimet e kërkuara nga kjo drejtori të cilat konsiderohen se do të jenë të nevojshme për hartimin e këtij plani.

IV.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga kuvendi i komunës.

V.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

VI.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe nepërmjet saj njoftohen organet të tjera relevante dhe Arkiva.

Kryesuesi i kuvendit,
Xhelal Gashi